



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “MATEMATIKË”

ARSIM FILLOR

KLASA 1

FUSHA “MATEMATIKË”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinatore: Dorina Rapti



PËRMBAJTJA

I. HYRJE	5
II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	6
2.1 Objektivat e përgjithshme të matematikës në arsimin fillor	6
III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	7
IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA	9
4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit	9
4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e matematikës	13
4.3 Kompetencat e lëndës së matematikës dhe rezultatet e të nxënit	14
V. PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	19
5.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e parë	19
5.2 Përmbajtja e klasës së parë	20
KLASA E PARË	20
5.2.1 Tematika: Numri	20
5.2.2 Tematika: Matja	24
5.2.3 Tematika: Gjeometria	25
5.2.4 Tematika: Algjebra dhe funksioni	26
5.2.5 Tematika: Statistika dhe probabiliteti	27

5.3 Qëndrime dhe vlera.....	28
5.4 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).....	29
VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	31
6.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e matematikës	33
6.2 Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e matematikës	33
6.3 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e matematikës	36
6.4 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e matematikës	36
VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE	37
7.1 Llojet e vlerësimit në lëndën e matematikës.....	37
7.2 Parime të rëndësishme të vlerësimit në arsimin fillor (matematikë)	38
7.3 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit (RN)	38
VIII.....	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE
40	
8.2 Përdorimi i teknologjisë si mjet dhe teknikë mësimore për zbatimin e qasjes STEM	41
IX. ANALIZA SASIORE E PROGRAMIT TË MATEMATIKËS NË KLASË TË 1 -RË.....	42
X. REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	44
a) Rekomandime për mësuesit.....	44
b) Rekomandime për autorët e teksteve shkollore.....	45

c)	<i>Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare</i>	45
d)	<i>Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm</i>	46
e)	<i>Rekomandime për prindërit</i>	46
f)	<i>Rekomandime për nxënësit</i>	46
XI.	NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE	47

<i>Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit në klasën e parë (Matematikë).</i>	10
<i>Tabela 2: Kompetencat matematikore dhe rezultatet e të nxënit</i>	15
<i>Tabela 3: Orët e sugjeruara për çdo tematikë</i>	20
<i>Tabela 4. Qëndrimet dhe vlerat</i>	28
<i>Tabela 5. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve</i>	29
<i>Tabela 6. Shembuj për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve</i>	39
 <i>Diagrama 1. Përmbajtja e programit të lëndës së matematikës</i>	8
<i>Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së matematikës</i>	15
<i>Diagrama 3. Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit</i>	34

I. HYRJE

Matematika është një pjesë shumë e rëndësishme e mësimave që zhvillohen në shkollë, pasi ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë botën që i rrethon. Kur mësojnë matematikën, nxënësit mësojnë jo vetëm të numërojnë, të masin apo njohin figurat gjeometrike, por edhe si të mendojnë qartë, të zgjidhin probleme dhe të gjejnë zgjidhje të mençura në situata të ndryshme të jetës së përditshme.

Gjatë mësimave të matematikës në arsimin fillor, nxënësit mësojnë që të shohin një problem, ta kuptojnë pjesë-pjesë dhe të gjejnë mënyrën më të mirë për ta zgjidhur. Ata mësojnë të analizojnë, të mendojnë me kujdes, të krahasojnë ide të ndryshme dhe të bëjnë zgjedhje të drejta, duke përdorur arsyetimin dhe provat që kanë. Matematika gjithashtu i mëson të bashkëpunojnë me shokët në grup, të ndajnë mendime dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin për të arritur zgjidhjen e duhur.

Mësimi i matematikës është i lidhur edhe me lëndët e tjera, si shkenca, letërsia apo historia etj. Kështu, nxënësit do të kuptojnë më lehtë pse matematika është e rëndësishme dhe si mund ta përdorin atë në jetën e përditshme. Ne e dimë që çdo nxënës mëson në mënyrën dhe ritmin e vet, ndaj mësimet e matematikës janë të larmishme, me ushtrime praktike, lojëra, projekte në grup dhe përdorim të teknologjisë. Kështu, çdo nxënës do të ketë mundësinë të mësojë dhe të gjejë mënyrën më të përshtatshme për të kuptuar matematikën.

Në arsimin fillor, nxënësit do të mësojnë rreth numrave, figurave gjeometrike, pozicionit në hapësirë, matjeve dhe do të zhvillojnë aftësi për të bërë llogaritje dhe për të zgjidhur probleme të thjeshta. Këto njohuri formojnë bazën për klasat e mëvonshme, ku do të mësohen tema të reja dhe më të thelluara, për t'u përgatitur për arsimin e mesëm të ulët dhe për jetën e përditshme.

Matematika është një nga shtatë fushat e kurrikulës së arsimit bazë dhe përmban vetëm lëndën e matematikës, e cila ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë thelbësore për shkollimin parauniversitar, duke u mësuar në të gjitha vitet e arsimit fillor.

II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Qëllimi i mësimi të matematikës në arsimin fillor është që nxënësit të ndërtojnë njohuritë e para themelore për botën përmes numrave, matjeve, figurave gjeometrike dhe zgjidhjes së problemeve të thjeshta, duke nxitur mendimin logjik, kureshtjen dhe vetëbesimin. Matematika ndihmon fëmijët të zhvillojnë mënyra të qarta dhe të strukturuar për të menduar, për të analizuar situata të përditshme dhe për të gjetur zgjidhje praktike, duke forcuar vetëbesimin e tyre si nxënës aktivë dhe të suksesshëm. Përmes lojës, ushtrimeve praktike, bashkëpunimit me shokët dhe përdorimit të teknologjisë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të menduar matematikisht, për të zgjidhur probleme dhe për të parë rëndësinë e matematikës në jetën e tyre të përditshme.

2.1 Objektivat e përgjithshme të matematikës në arsimin fillor

Në përfundim të arsimit fillor, synohet që nxënësi:


- të njohë dhe të përdorë numrat në situata të përditshme: numërim, krahasim, renditje, mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim;
- të njohë dhe të përdorë figurat gjeometrike për të kuptuar hapësirën dhe formën;
- të matë dhe të krahasojë madhësitë si gjatësia, masa, koha dhe vëllimi me njësi matëse të përshtatshme;
- të zhvillojë aftësi për të zgjidhur probleme, duke përdorur mendimin logjik dhe intuitën matematikore;
- të interpretojë dhe të analizojë të dhëna të paraqitura në tabela apo grafikë të thjeshtë;
- të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet shkak - pasojë ndërmjet dukurive;
- të mësojë të argumentojë me fjalë të thjeshta zgjedhjet që bën gjatë zgjidhjes së problemeve;
- të eksplorojë lidhjen e matematikës me situata reale në jetën e përditshme dhe në fushat e tjera të dijes, si shkenca, teknologjia dhe natyra;
- të punojë në mënyrë bashkëpunuese me shokët për të zgjidhur detyra ose për të ndarë ide matematikore;
- të përdorë teknologjinë dhe mjetet vizuale për të lehtësuar llogaritjet dhe për të paraqitur zgjidhje;
- të zhvillojë qëndrime pozitive ndaj matematikës duke përjetuar kënaqësi dhe besim në aftësitë e tij;

- *të kuptojë rëndësinë e të menduarit matematikor* si mjet për të marrë vendime të zgjuara në situata të jetës së përditshme.
- *të zhvillojë të menduarin kompjuterik* duke krijuar marrëdhënie sinergjike dhe reciproke me të menduarin matematikor.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i matematikës synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe kontekstin shkollor. Në thelb, ky program përqendrohet në formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar njohuritë matematikore në mënyrë funksionale dhe të ndërgjegjshme në jetën e tyre të përditshme. Programi i lëndës së matematikës në arsimin fillor përmban:

Diagrama 1. Përmbajtja e programit të lëndës së matematikës



 *Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit që zhvillohen nëpërmjet lëndës së matematikës.* Lënda e matematikës kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e kompetencave kyçe si dhe aftësive të shekullit XXI si: të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve, aftësitë e buta, aftësitë sociale, aftësitë digjitale etj. Përmes përmbajtjes së saj, matematika ndihmon në formimin e qytetarit të aftë për të menduar logjikisht, për të analizuar situata dhe për të marrë vendime të informuara në jetën e përditshme.

 *Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së matematikës.* Programi i matematikës ndërthur njohuritë dhe aftësitë e saj me temat ndërkurrikulare si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik dhe siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media duke i lidhur konceptet matematikore me situata konkrete që nxënësit përballen në jetën e tyre.

 *Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit.* Lënda e matematikës synon të pajisë nxënësit me kompetenca që shkojnë përtej thjesht njohjes së formulave apo rregullave, duke u ofruar atyre aftësi për të zbuluar, kuptuar dhe zgjidhur situata reale përmes një mendimi të strukturuar dhe logjik. Ky proces kërkon që ata të zhvillojnë aftësi në zgjidhjen e problemeve, të argumentojnë bindshëm, të ndërtojnë dhe vërtetojnë hipoteza, si dhe të komunikojnë idetë dhe zgjidhjet e tyre në mënyrë të qartë dhe efektive. Gjithashtu, lënda e matematikës i pajis nxënësit me aftësi të të menduarit kompjuterik dhe i udhëzon ata në përdorimin e teknologjisë si mjet për zgjidhjen e problemeve, për analizimin e të dhënave, programim dhe modelim digjital.

- 📖 *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit.* Në këtë rubrikë përshkruhet koha e dedikuar (numri i orëve mësimore) në varësi të klasës dhe kompleksitetit të tematikave, duke ofruar hapësirë për punë individuale, në grup dhe për projekte; tematikat e lëndës dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre; njohuritë kryesore, aftësitë për secilën tematikë dhe qëndrimet që demonstroi nxënësi.
- 📖 *Metodologjia e mësimdhënies.* Në lëndën e matematikës është e rëndësishme t'i kushtohet një vëmendje e madhe përdorimit të metodave interaktive, teknikave të menduarit kritik, zgjidhjes problemore dhe bashkëpunimit. Puna me projekte të integruara dhe detyra problemore janë në fokus të zhvillimit të lëndës. Përshatja e mësimi për nxënësin me nevojë të veçanta dhe mbështetja e talentëve në lëndën e matematikës nxit kuriozitetin për lëndën. Në këtë rubrikë do të ketë edhe disa shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- 📖 *Vlerësimi i nxënësve është një tjetër rubrikë,* e cila përshkruan në mënyrë të përmbledhur llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit, vlerësimin si metodologji të nxëni. Gjithashtu në këtë rubrikë do të ketë edhe shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënit.
- 📖 *Burimet dhe materialet didaktike* që mund të përdoren në lëndën e matematikës. Zbatimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale si mjete ndihmëse do të trajtohet gjithashtu në program si burime të rëndësishme për zhvillimin e aftësive matematikore.
- 📖 *Rekomandime për zbatimin e programit.* Në këtë rubrikë do të ketë disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor siç janë: nxënësit, mësuesit, hartuesit e teksteve mësimore, hartuesit e testeve kombëtare, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit.
- 📖 *Ndryshimet përmbajtësore.* Në këtë rubrikë do të përshkruhen përditësimet e fundit në përmbajtjen lëndore.

IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës, sipas klasave të arsimit fillor. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave

të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive.

Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballë me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja në mësimdhënien e bazuar në kompetenca zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke e vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe, që mund të zhvillojë nxënësi në klasën e parë në lëndën e matematikës mund të përmbledhen si më poshtë:

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit në klasën e parë (Matematikë).

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> - dëgjon me vëmendje dhe kupton mesazhet e të tjerëve; - shpreh qartë mendimet, ndjenjat dhe nevojat e tij me fjali të thjeshta; - lexon fjalë, fjali dhe tekste të thjeshta, duke i kuptuar ato; - shkruan fjali të thjeshta, duke përdorur drejtshkrimin e saktë; - përdor fjalë të reja dhe kupton fjalët që dëgjon apo lexon; - bën pyetje dhe jep përgjigje gjatë bisedave me mësuesin dhe shokët e klasës; - merr pjesë në punë në grup, duke bashkëbiseduar dhe duke ndihmuar shokët; - prezanton me gojë ose me vizatime njohuritë ose punët që ka përgatitur vetë;	<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> - kupton mesazhet e thjeshta; - lexon dhe shkruan tekste të thjeshta; - përdor mjete dhe flet në mënyrë të thjeshtë; - përshkruan ngjarje që ka lexuar ose dëgjuar;

- përdor gjuhën për të shprehur mendime, ide dhe ndjenja për situata të ndryshme.	
Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri	Kompetenca digjitale
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> - përdor numra dhe veprimet për të zgjidhur probleme të thjeshta; - përdor arsyetim të thjeshtë për të zgjidhur probleme; - flet dhe shkruan me numra dhe simbole; - bën eksperimente të thjeshta për të mësuar rreth natyrës; - mbledh dhe përdor informacion për të kuptuar më shumë; - kupton si bëhen kërkimet dhe përdor prova për të mësuar; - shkruan dhe vizaton për të mbajtur informacion dhe për të treguar ide; - radhit dhe organizon gjërat që ka mësuar; - përdor pyetje për të mësuar dhe për të gjetur përgjigje; - ndjek udhëzimet dhe simbolet për të bërë detyra; - shpjegon dhe përdor fakte për të mbështetur mendimin e tij; - tregon si zgjidh një detyrë apo problem; - tregon shembuj nga jeta për të shpjeguar gjërat që ka mësuar.	<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> - përdor kompjuterin; - përdor mjete digjitale për të mësuar; - përdor ndihmën e teknologjisë, IA për të mësuar gjëra të reja; - përdor teknologjinë për të punuar së bashku me shokët për projekte; - përdor komanda të thjeshta; - përdor teknologjinë për të zhvilluar mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> - identifikon përparësitë dhe dobësitë e tij dhe punon për të përmirësuar ato që nuk i di mirë;	<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> - bashkëpunon me të tjerët për të zgjidhur probleme në shkollë dhe komunitet;

- motivon dhe vlerëson veten për punën dhe përpjekjet e tij; - mëson dhe punon në mënyrë të pavarur dhe me të tjerët, duke bashkëpunuar me shokët; - kupton rëndësinë e mësimin çdo ditë; - menaxhon kohën dhe burimet për të mësuar dhe për të bërë punët e tij; - menaxhon emocionet dhe stresin dhe zgjidh problemet me të tjerët pa u inatosur; - kupton rëndësinë e jetesës së shëndetshme dhe merr pjesë në aktivitete fizike; - përdor ushqim të shëndetshëm dhe kujdeset për higjienën për të qëndruar i shëndetshëm; - vepron në mënyrë pozitive gjatë punës me të tjerët; - kupton dhe kërkon ndihmë nga personat e duhur në situata të vështira për shëndetin dhe sigurinë; - mbron shëndetin dhe sigurinë e tij duke shmangur rreziqet dhe infeksionet;	- merr pjesë në aktivitete që ndihmojnë të tjerët dhe komunitetin; - merr pjesë në vendimmarrje në klasë ose me shokët; - respekton të drejtat e të tjerëve dhe lufton diskriminimin dhe paragjykimet; - zgjidh konfliktet në mënyrë paqësore, duke dëgjuar dhe kuptuar mendimet e të tjerëve; - mbron mjedisin dhe kujdeset për natyrën; - reagon kur dikush shkel të drejtat e të tjerëve dhe tregon shembuj të veprimeve të gabuara; - ndihmon ata që kanë nevojë, duke ofruar ndihmë kur dikush është në rrezik; - merr pjesë në votime për të vendosur për aktivitete të shkollës; - mban sjellje të mira, duke treguar qetësi dhe maturi kur ndodhin veprime të gabuara;
Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> - përdor imagjinatën për të krijuar ide të reja; - dallon pikat e forta dhe ato të dobëta në një ide ose projekt; - vlerëson rëndësinë e punës në grup për të bërë më të mirën në shkollë dhe komunitet;	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - shpreh emocionet dhe idetë e tij me art dhe forma të tjera; - shijon dhe pëlqen veprat e artit;

- kupton se si dëmtimi i mjedisit ndikon tek jeta e njeriut dhe krijon aktivitete për ta mbrojtur atë; - bën një plan për shpenzimet dhe kursimet.	- shpreh veten në mënyra të ndryshme, si p.sh. nëpërmjet vizatimit ose këngës; - përdor artin për të treguar vlera të tij ose të tjerëve; - punon dhe krijon në mënyrë individuale dhe me shokët e klasës.
---	--

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e matematikës

Lidhja e temave ndërkurrikulare me lëndën e matematikës është një mundësi për të integruar njohuritë matematikore në kontekste të jetës reale dhe për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësi të rëndësishme që lidhen me botën që i rrethon. Çdo temë ndërkurrikulare mund të zhvillohet dhe mbështetet nga koncepte dhe aftësi matematikore, të cilat jo vetëm që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe analizojnë botën, por gjithashtu i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi kritike dhe analitike.

- ✓ *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.* Matematika mund të përdoret për të kuptuar dhe analizuar elemente të identitetit dhe kulturës nëpërmjet statistikave dhe të dhënave. P.sh., nxënësit mund të përdorin matematikën për të mbledhur dhe organizuar të dhëna për kulturat dhe traditat e ndryshme. Ata mund të krijojnë grafikë dhe tabela për të treguar preferencat e ndryshme kulturore, si ngjyrat e preferuara, ushqimet tradicionale, ose festat.
- ✓ *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.* Në këtë temë, matematika mund të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë për të kuptuar dhe menaxhuar burimet, kostot dhe përfitimet e ideve sipërmarrëse. Për shembull, nxënësit mund të përdorin matematikën për të llogaritur buxhetin e aktiviteteve shkollore, si p.sh. organizimin e një ngjarjeje ose një panairi shkollor. Ata mund të mësojnë rreth kostove, mbledhjes së parave, dhe ndarjen e burimeve për të krijuar një aktivitet të suksesshëm
- ✓ *Shëndeti mendor e fizik dhe siguria.* Matematika mund të lidhet me këtë temë përmes analizës statistikore të të dhënave që lidhen me shëndetin, si shkalla e aktiviteteve fizike, konsumi i ushqimeve të shëndetshme dhe matja e parametrave të trupit (p.sh., pesha, gjatësia). Përdorimi i matematikës mund të ndihmojë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e numrave për planifikimin e aktiviteteve fizike, si p.sh. numri i hapave që bëjnë gjatë një aktiviteti ose llogaritja e kohës që duhen për ushtrime të ndryshme.

- ✓ *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.* Matematika ka një rol të rëndësishëm në kuptimin dhe analizimin e të dhënave që lidhen me mjedisin, siç janë ndotja, energjia e rinovueshme dhe përdorimi i burimeve natyrore. Nxënësit mund të krijojnë tabela dhe grafikë për të ndjekur përdorimin e ujit dhe energjisë në shkollë.
- ✓ *Teknologjia, shoqëria dhe media.* Përdorimi i teknologjisë dhe medias mund të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësi të matematikës përmes analizës së të dhënave të mbledhura nga burime të ndryshme, siç janë interneti dhe platformat sociale. Ata mund të përdorin matematikën për të kuptuar dhe analizuar të dhëna të ndryshme që mund të shohin në mediat sociale.

Veprimtaritë praktike për zhvillimin e temave ndërkurrikulare mund të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3 Kompetencat e lëndës së matematikës dhe rezultatet e të nxënit

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e matematikës synon të përmbushë gjashtë kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që realizohen përmes pesë tematikave kryesore. Këto kompetenca zbërthehen në rezultate të të nxënit për secilën klasë.

Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së matematikës




Tabela 2: Kompetencat matematikore dhe rezultatet e të nxënësit

Kompetencat matematikore që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënësit për kompetencat në fund të klasës së parë
--	---------------------------	--

<i>Zgjidhja problemore në matematikë</i>	Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore të nivelit praktik të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt, duke zhvilluar kapacitetin intelektual dhe intuitën krijuese. Zgjidhja problemore shpesh përfshin edhe bashkëpunim dhe punë në ekip, pasi individët punojnë së bashku për të zhvilluar dhe zbatuar zgjidhje efektive. Kjo kërkon aftësinë për të punuar në mënyrë efektive me të tjerët, për të shkëmbyer ide dhe për të ofruar dhe marrë reagime konstruktive. Në përgjithësi, kompetenca e zgjidhjes problemore është thelbësore për suksesin në matematikë dhe në shumë fusha të tjera, pasi u mundëson individëve të trajtojnë probleme komplekse dhe të zhvillojnë zgjidhje novatore.	Nxënësi: ✓ identifikon dhe përdor për të zgjidhur probleme të thjeshta; ✓ përdor objektet dhe figurat për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjes së një problemi; ✓ tregon dhe shpjegon mënyrën e zgjidhjes së problemeve.
<i>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik</i>	Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. Arsyetimi ka të bëjë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita. Kjo përfshin përdorimin e deduksionit dhe induksionit logjik për të nxjerrë përfundime bazuar në vetitë dhe marrëdhëniet matematikore. Vërtetimi, nga ana tjetër, përfshin ofrimin e një argumenti logjik dhe rigoroz për të demonstruar vërtetësinë e një pohimi ose pretendimi matematikor. Kjo përfshin përdorimin e aksiomave, përkufizimeve dhe teknikave matematikore të vendosura për të nxjerrë rezultate të reja dhe për të justifikuar vlefshmërinë e pretendimeve matematikore. Arsyetimi dhe prova matematikore janë kompetenca thelbësore për suksesin në matematikë dhe në shumë fusha të tjera, pasi u mundësojnë individëve të	Nxënësi: ✓ përdor numra dhe figura për të treguar dhe shpjeguar një situatë matematike; ✓ mendon dhe shpjegon pse një zgjidhje është e saktë; ✓ krijon dhe vlerëson prova të thjeshta matematikore duke përdorur numra dhe figura.

	zhvillojnë dhe komunikojnë ide dhe zgjidhje novatore dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike vlefshmërinë e pretendimeve dhe argumenteve të tyre.	
<i>Të menduarit dhe komunikimi matematik</i>	Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik. Gjatë komunikimit në gjuhën matematikore mësohen koncepte, procese dhe përforcohet të kuptuarit e tyre. Gjuha matematike përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme. Kjo kompetencë përfshin aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe abstrakte rreth koncepteve matematikore dhe për të komunikuar idetë dhe zgjidhjet matematikore në mënyrë të qartë dhe efektive. Mendimi dhe komunikimi matematikor janë thelbësore për suksesin në matematikë dhe në shumë fusha të tjera, pasi u mundësojnë individëve të zgjidhin probleme komplekse, të zhvillojnë koncepte dhe teknika të reja matematikore dhe t'ua komunikojnë idetë e tyre të tjerëve. Të menduarit dhe komunikimi efektiv matematik kërkon aftësinë për të punuar në bashkëpunim me të tjerët, për të shkëmbyer ide dhe për të ofruar dhe marrë reagime konstruktive. Ai gjithashtu përfshin njohjen dhe respektimin e këndvështrimeve dhe qasjeve të ndryshme ndaj problemeve dhe zgjidhjeve matematikore, si dhe të qenit i hapur ndaj zgjidhjeve dhe ideve alternative.	Nxënësi: ✓ përdor gjuhën e matematikës për të shpjeguar dhe diskutuar idetë dhe problemet matematikore; ✓ shpreh dhe shpjegon mendimet dhe zgjidhjet matematike me të tjerët; ✓ përdor vizatime dhe figura për të treguar ide të ndryshme matematike.
<i>Lidhja konceptuale</i>	Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematikore për të formuar një të tërë dhe përdorur varësitë ndërmjet këtyre koncepteve. Kjo kompetencë është e rëndësishme sepse matematika është një lëndë shumë e ndërlikuar, ku koncepte dhe ide të ndryshme shpesh ndërlidhen dhe ndërtohen mbi njëra-tjetrën.	Nxënësi: ✓ mëson se si idetë dhe numrat janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe si mund të përdoren për të zgjidhur probleme;

	Aftësia për të krijuar lidhje konceptuale përfshin njohjen e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet koncepteve matematikore dhe të kuptuarit sesi konceptet e ndryshme lidhen me njëri-tjetrin. Ajo gjithashtu përfshin aftësinë për të transferuar njohuri dhe aftësi nga një kontekst në tjetrin, dhe për të zbatuar koncepte dhe teknika matematikore për të zgjidhur probleme në fusha të ndryshme. Lidhja konceptuale efektive kërkon gjithashtu aftësinë për të vizualizuar dhe paraqitur idetë matematikore në mënyra të ndryshme, si përmes diagrameve, grafikëve dhe paraqitjeve simbolike.	✓ lidh njohuritë e mëparshme për të kuptuar më mirë situatat dhe problemet; ✓ përdor matematikën për të kuptuar dhe zgjidhur probleme nga jeta e përditshme.
<i>Modelimi matematik</i>	Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdor veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Nëpërmjet përdorimit të teknikave përkatëse, gjendet zgjidhja matematikore e cila më pas interpretohet në jetën reale. Kjo kompetencë është e rëndësishme sepse modelet matematikore përdoren në shumë fusha, duke përfshirë inxhinierinë, fizikën, biologjinë, ekonominë, mjekësinë, shkencat sociale, për të kuptuar sistemet komplekse, për të bërë parashikime dhe për të projektuar zgjidhje. Modelimi efektiv matematik kërkon gjithashtu aftësinë për të analizuar dhe interpretuar modelet matematikore dhe për t'i përdorur ato për të bërë parashikime dhe për të projektuar zgjidhje.	Nxënësi: ✓ përdor matematikën për të shprehur situata të jetës reale si p.sh. numërimin e sendeve në klasë; ✓ përdor modele të thjeshta për të treguar se si mund të zgjidhen problemet.
<i>Të menduarit kompjuterik dhe përdorimi i teknologjisë</i>	Nxënësi zhvillon aftësinë e të menduarit kompjuterik për njohjen e modelit, dizenjimin dhe përdorimin e abstraksionit, zbërthimin e modelit, përcaktimin se cilat (nëse ka) mjete kompjuterike mund të përdoren në analizimin ose zgjidhjen e një problemi dhe përcaktimin e algoritmeve si pjesë e një zgjidhjeje të detajuar. Përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione. Kjo kompetencë u ofron nxënësve	Nxënësi: ✓ përdor kompjuterin dhe makina llogaritëse për të bërë llogaritje dhe për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve;

	mjete për të eksploruar, vizualizuar dhe zgjidhur problemet matematikore në mënyrë më efektive. Disa aftësi kryesore që lidhin përdorimin e teknologjisë në matematikë janë: aftësi me softuer matematikor: analiza dhe vizualizimi i të dhënave, ndërtimi dhe vizualizimi gjeometrik, programimi dhe kodimi kompjuterik: burimet në internet dhe platformat arsimore: bashkëpunimi digjital, vlerësimi kritik i teknologjisë, përdorimi etik dhe i përgjegjshëm i teknologjisë.	✓ përdor teknologjinë për të vizualizuar dhe shpjeguar konceptet matematikore në mënyra interesante dhe krijuese;
--	---	--

V. PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e parë

Lënda e matematikës zhvillohet për 35 javë mësimore, me nga 4 orë në javë (45 min.), pra gjithsej 140 orë për secilën klasë. Programi i matematikës përcakton peshën (orët e sugjeruara) për secilën tematikë në çdo klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me numrin total të orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë. Shpërndarja e orëve ka për qëllim që përdoruesit e

programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në raport me orët totale vjetore.

Tabela 3: Orët e sugjeruara për çdo tematikë

Klasa e parë	Numri	Matja	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni	Statistika dhe probabiliteti	Gjithsej orë
	96	18	14	6	6	140 orë

5.2 Përmbajtja e klasës së parë

Në programin e matematikës për klasën e parë janë paraqitur tematikat përmbajtësore: **Numri, Matja, Gjeometria, Algjebra dhe funksioni, Statistika dhe probabiliteti**. Këto tematika përbëjnë bazën për ndërtimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave. Tematikat përmbajnë rezultatet e të nxënit për çdo klasë. **Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë dhe aftësitë që duhet të demonstrojnë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse, si dhe qëndrimet dhe vlerat që ai shfaq në lëndën e matematikës**

Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja vjetore duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Kombinimi i koncepteve dhe i shprehive matematikore në situata të të nxënit, kapituj apo grupe temash dhe njësi mësimore, si dhe renditja e tyre, është përgjegjësi e përdoruesve të programit (kryesisht mësuesit dhe autorët e teksteve shkollore). Për “përkthimin” e programit në tekste mësimore, aftësitë dhe orët e tematikave do të shpërndahen në kapituj/njësi mësimore të renditura në mënyrë logjike, njëra pas tjetrës..

Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë totale të orëve vjetore të lëndës, por kanë të drejtë të ndryshojnë me $\pm 10\%$ orët e rekomanduara për secilën tematikë.

KLASA E PARË

5.2.1 Tematika: Numri

NUMRI

Përshkrimi i tematikës: Nxënësi përdor kuptimin e numrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe algoritmin e veprimeve me numra për të paraqitur sasi në botën reale. Nxënësi numëron deri në 100; lexon, shkruan e përdor numrat deri në 100; krahason numrat duke përdorur edhe simbolikën përkatëse; vlerëson me sy numrin e një sasive sendesh, pa i numëruar. Nxënësi ndërton njohuri fillestare për veprimet, mbledhjet e zbritjet me mend dhe shkrim të dy numrave, merr koncepte fillestare për shumëzimin dhe për pjesëtimin, thjesht si ndarje në grupe të barabarta.

Njohuritë

Numri natyror

- Numërimi nga 0-100 me anë të konkretizimeve.
- Numërimi i një grupi sendesh deri në 20, duke filluar nga cilido prej tyre.
- Njohja e numrit të objekteve të paraqitura në modele të njohura deri në 10, pa i numëruar.
- Numërimi me nga 1, duke filluar nga çdo numër (jo më shumë se 100 numrat e parë).
- Numërimi në rendin zbritës, duke filluar jo më shumë se 20.
- Numërimi me dhjetëshe të plota duke filluar nga një dhjetëshe e plotë (në rendin rritës dhe në rendin zbritës) deri në 100.
- Numërimi me nga 2 për 20 numrat e parë për të kuptuar në mënyrë fillestare, numrat çift dhe tek.
- Identifikimi brenda 30 numrave të parë, i numrit me 1 ose 10 më pak se një numër i dhënë.

Aftësitë

Numri natyror

Nxënësi:

- lexon dhe shkruan numra natyrorë deri në 20, duke kuptuar lidhjen ndërmjet vendit të çdo shifre me vlerën e saj;
- dallon dhe emërton sendet;
- numëron disa numra: me nga një, brenda qindësesh së parë (duke filluar nga çdo numër), si dhe me dhjetëshe të plota duke filluar nga një dhjetëshe e plotë (në rendin rritës dhe zbritës);
- numëron në rendin zbritës 20 numrat e parë;
- dallon numra çift dhe numra tek (bazuar në konkretizime);
- përshkruan renditjen e objekteve me një gjuhë të thjeshtë matematikore;
- identifikon brenda 30 numrave të parë numrin që është 1 ose 10 më pak se një numër i dhënë;
- njeh dhe përdor numrat rendorë nga 1 deri në 10;
- kupton se numri zero tregon mungesën e plotë të një sasive apo objekti;

- Numri rreshtor (jo më shumë se 10 numra). - Vlerësimi sasi i një grupi sendesh me anë të numërimit. - Numri dyshifror në trajtë të zbërthyer dhe anasjellas (numrat 11 deri 20). Krahasimi i numrave - Krahasimi i dy numrave dhe sendeve duke përdorur shprehjet “më shumë”, “më pak”, “po aq”. - Renditja e disa numrave të dhënë, nga më i madhi te më i vogli dhe anasjellas, bazuar te paraqitjet konkrete nga 0-20. - Vija e graduar me numra/boshti numerik. - Gjetja e një numri ndërmjet dy numrave të dhënë deri në 20. Thyesat - Gjysma e numrave njëshifrorë me mjete konkrete dhe ilustrime. Mbledhja e zbritja - Mbledhja si shtim, si bashkim, me anë të mjeteve konkrete e ilustrimeve. - Zbritja si pakësim, si plotësim më anë të mjeteve konkrete e ilustrimeve. - Mbledhja dhe zbritja e dy numrave njëshifrorë. - Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes. - Përdorimi i simboleve +, - dhe =.	- vlerëson sasinë e një grupi sendesh rreth 30; - paraqet një numër dyshifror deri në 20, në trajtë të zbërthyer. Krahasimi i numrave Nxënësi: - krahason dy numra, grupe sendesh me mjete praktike duke përdorur shprehjet “më shumë”, “më pak”, “po aq”. - rendit disa numra njëshifrorë dhe dyshifrorë në rendin rritës ose zbritës nga 0 -20. - përdor boshtin numerik për të gjetur një numër ndërmjet dy numrave të dhëna deri në 20. Thyesat - dallon gjysmën e numrave njëshifrorë duke përdorur sende dhe objekte nga jeta reale; - dallon se një objekt apo formë mund të ndahet si në pjesë të barabarta, ashtu edhe në pjesë të pabarabarta; - njeh gjysmën si një nga dy pjesët e barabarta të një sasi ose grupi objektësh; - kupton se gjysma përdoret për të ndarë një numër në dy pjesë të barabarta dhe se rezultati është një numër i plotë; - kupton dhe dallon se dy gjysma mund të bashkohen për të formuar një të tërë. Mbledhja dhe zbritja
--	---

- Vetia ndërruese e mbledhjes me mjete konkrete (pa përdorimin e barazimeve formale). - Mbledhja e një numri dyshifror, me dhjetëshe të plota ose jo, me një numër njëshifror pa kalim të dhjetës. Shumëzimi dhe pjesëtimi - Dyfishimi i numrave njëshifrorë. - Gjetja gjysmës së numrave çift (24,6,8,10) me anë të objekteve. - Ndarja e numrave njëshifrorë në numra çift dhe tek. - Ndarja e objekteve në një kontekst të dhënë në dy grupe të barabarta. Strategji të veprimeve me mend - Mbledhja dhe zbritja deri në 10. - Mbledhja dhe zbritja e numrave me veten (numrat 6,7,8,9,10). - Mbledhja e 3 numrave njëshifrorë ku dy prej numrave kanë shumën 10 (p.sh., $4 + 3 + 6 = 10 + 3 = 13$). - Përdorimi i numrave që kanë shumën 10, si urë për mbledhjen/zbritjen e numrave njëshifrorë (p.sh., $8 + 3$, mbledhim $8 + 2 + 1 = 10 + 1 = 11$). - Dyfishi i numrave 2 dhe 10. - Veprime me mend duke përdorur dyfishimin (p.sh., $5 + 6 = 5 + 5 + 1$).	Nxënësi: - identifikon termat “shumë” dhe “ndryshesë”; - mbledh dy numra njëshifrorë; - mbledh tre numra njëshifrorë duke zbatuar vetinë e ndërrimit të mbledhjes nga 0-20; - zbret dy numra njëshifrorë; - mbledh një numër dyshifror me një numër njëshifror pa kalim të dhjetës deri në 20; - zgjidh problema me situata të njohura për ta. Shumëzimi dhe pjesëtimi - dyfishon numrat njëshifrorë; - dallon me mjete praktike gjysmën e numrave njëshifrorë që ndahen në mënyrë të barabartë (numra çift njëshifrorë); - ndan në dy grupe të barabarta një sasi objektësh të dhënë; - zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta. Strategji të veprimeve me mend Nxënësi: - përdor strategji të ndryshme për të kryer veprime të thjeshta me mend.
--	--

5.2.2 Tematika: Matja

MATJA

Përshkrimi i tematikës: Nxënësi zbaton proceset e matjes dhe përzgjedh teknika të përshtatshme për të kryer matje direkt në situata reale. Ai orientohet në kohë dhe kryen renditjen në kohë të ngjarjeve që kanë të bëjnë me jetën e tyre të përditshme. Nxënësi ndërton njohuri fillestare të përdorimit në matje të njësive standarde: m, cm, kg, orë, ditë, javë, muaj, vit dhe të monedhave. Njehsimet kufizohen në matjen e gjatësisë, kohës, masës dhe përdorimin e monedhave.

Njohuritë	Aftësitë
Gjatësia - Krahasoni i sendeve sipas gjatësisë me sy ose duke i vendosur njëri mbi tjetrin pa përdorur njësitë standarde. - Përdorimi i terminologjisë përkatëse (“më i gjatë”, “po aq i gjatë”, “më i shkurtër”, “më i gjati”, “më i shkurtri” “i hollë”, “më i hollë”, “i lartë”, “më i lartë”). Koha - Leximi i orës me orë të plota dhe në gjysmë. - Minuta, ora, dita, java, muaji dhe viti, renditja e ditëve të javës dhe e muajve të vitit. Pesha - Krahasoni i sendeve sipas peshës. - Përdorimi i terminologjisë përkatëse (“më i rëndë”, “më i lehtë”, “po aq i rëndë”, “më i rëndi”, “më i lehti”).	Gjatësia Nxënësi: - krahason drejtpërdrejt gjatësitë e sendeve duke përdorur shprehjet: “më i gjatë”, “po aq i gjatë”, “më i shkurtër”, “më i gjati”, “më i shkurtri” “i hollë”, “më i hollë”, “i lartë”, “më i lartë”; - krahason me sy gjatësitë e dy ose më shumë sendeve; - kërkon dhe zgjedh mjetin e shkallëzuar të përshtatshëm për të matur gjatësinë, masën, kapacitetin dhe temperaturën. Koha Nxënësi: - orientohet në kohë duke përdorur fjalët e duhura (p.sh., dje, para një jave, tani, nesër, pas disa ditësh, pas dy muajsh etj.) në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme; - njeh kohën në orë dhe gjysmë;

Monedhat – Njohja me monedhat nga 10- lekëshe deri në 100-lekëshe. – Parashikimi i mundësisë për një blerje që lidhet me një sasi të caktuar lekësh. Vëllimi - Krahassimi i vëllimit të enëve në mënyrë konkrete (pa njësi standarde).	- rendit ditët e javës, muajt e vitit; - rendit ngjarje që kanë lidhje me jetën e tyre të përditshme, brenda një periudhe kohore prej një dite, disa ditësh, disa muajsh. Pesha Nxënësi: - përdor terminologjinë përkatëse (“më i rëndë”, “më i lehtë”, “po aq i rëndë”, “më i rëndi”, “më i lehti”), për të shprehur masën e sendeve nga jeta e tij e përditshme; - demonstroi peshimin me anë të balancës duke përdorur sende të ndryshme. Monedhat Nxënësi: - përdor monedhat, nga 10-lekëshe deri në 100-lekëshe për të llogaritur çmime të sendeve nga jeta e tij e përditshme; - zgjidh problema nga situata me blerje të njohura për ta. Vëllimi Nxënësi: - krahason vëllimin e enëve të ndryshme, të njohura për ta.
---	--

5.2.3 Tematika: Gjeometria

GJEOMETRIA

Përshkrimi i tematikës: Nxënësi përdor arsyetimin për të zbuluar marrëdhëniet gjeometrike për figurat 2D (dydimensionale). Nxënësi zgjeron

njohuritë për format dydimensionale (katror, rreth, drejtkëndësh, trekëndësh) dhe përshkruan disa prej tyre në bazë të numrit të brinjëve e kulmeve, me anë të ilustrimeve konkrete. Ai trajton në mënyrë intuitive njohuri për simetrinë boshtore.

Njohuritë	Aftësitë
Gjeometria në plan - Rrethi, katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi. Gjeometria në hapësirë - Kubi, kuboidi, cilindër, kon, sferë. Shndërrimet gjeometrike - Vendndodhja dhe termat: para, pas, mbi, nën, majtas, djathtas, ndërmjet etj. - Figura simetrike.	Gjeometria në plan Nxënësi: - dallon dhe emërton format 2D (katror, trekëndësh, rreth, drejtkëndësh, rreth); - përshkruan format 2D duke treguar veçoritë e tyre, si numri i brinjëve dhe nëse ato janë të drejta apo të lakuara. Gjeometria në hapësirë Nxënësi: - dallon objekte praktike dhe ilustrime në formë kubi, kuboidi, cilindri, koni, sferë; - përshkruan objekte me forma 3D bazuar në veçoritë e tyre, si numri i faqeve, i kulmeve dhe nëse faqet janë të sheshta apo të lakuara; - bën dallimin mes formave 2D dhe 3D duke përdorur si shembuj objekte praktike. Shndërrime gjeometrike Nxënësi: - përdor termat: para, pas, mbi, nën, majtas, djathtas, ndërmjet etj., për të treguar vendndodhjen e një objekti, sendi, personi etj.; - dallon figura simetrike nga jeta e përditshme; - zbulon kur një objekt apo person duket njësoj edhe pasi është rrotulluar.

5.2.4 Tematika: Algjebra dhe funksioni

ALGJEBRA DHE FUNKSIONI

Përshkrimi i tematikës: Nxënësi zbulon ligjësi, përdor kuptimin për numrin që mungon dhe përdor simbolet për të modeluar marrëdhënie në situata praktike. Ekuacionet janë në funksion të veprimeve me numra, duke u kufizuar në mbledhje e zbritje me numra të vegjël. Lidhur me funksionin, nxënësi mëson të dallojë një ligjësi, nëpërmjet modeleve konkrete, kryesisht me karakter zbavitës, me vargje.

Njohuritë	Aftësitë
Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve - Kutiza si vendmbajtëse numrash në barazime me mbledhje të dy numrave njëshifrorë me shumë deri në 20. Funksioni - Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli (vargu) konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie që ka të bëjë me ngjyrën, formën ose madhësinë.	Zgjidhja e ekuacioneve, inekuacioneve, sistemeve të ekuacioneve Nxënësi: - gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime, me mbledhje ose me zbritje brenda numrit 20. Funksioni Nxënësi: - dallon dhe vazhdon një varg, i cili ka të bëjë me ndryshimin sipas një ligjësie me një ose dy kritere (p.sh., ndryshimi i ngjyrës dhe formës).

5.2.5 Tematika: Statistika dhe probabiliteti

STATISTIKA DHE PROBABILITETI

Përshkrimi i tematikës: Nxënësi lexon dhe kupton të dhënat statistikore (me figura të ndryshme) nga jeta e përditshme. Ai lexon dhe plotëson një tabelë me të dhëna të thjeshta nga mjedisi i tyre.

Njohuritë	Aftësitë
Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të	Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të

dhënave - Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektsh, sipas një cilësie të përbashkët. - Piktogramet. - Diagrama e Venit - Diagrama e Carrolit.	dhënave Nxënësi: - grumbullon, zbulon ose klasifikon grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie ose dy cilësive të përbashkëta (ngjyra, forma, trashësia etj.); - përdor piktogramet, diagramin e Venit dhe diagramin e Carrolit; - përshkruan të dhëna duke përdorur gjuhë të kuptueshme si “më shumë”, “më pak”, “më së shumti” ose “më së paku”, për t’iu përgjigjur pyetjeve jo statistikore dhe për të diskutuar përfundimet.
--	--

5.3 Qëndrime dhe vlera

Në lëndën e matematikës nxënësi demonstroi qëndrimet dhe vlerat si më poshtë:

Tabela 4. Qëndrimet dhe vlerat

Nxënësi: - Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij; - Është inovativ dhe paraqet idetë e reja të tij; - Organizon lidhjen konceptuale të njohurive; - Përdor imagjinatën për zgjidhjen e problemeve me numra; - Vetëvlerësohet në situata të thjeshta; - Demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; - Demonstroi besim në forcat vetjake; - Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjerë (madje edhe të kundërta) duke treguar	
---	--

5.4 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve)

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj veprimtarish që mund të përdoren nga mësuesi për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

Tabela 5. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve

<i>Rezultatet e të nxënit</i>	<i>Shembuj të veprimtarive praktike</i>
<i>Shembull 1.</i> <i>Nxënësi rendit ngjarje që kanë lidhje me jetën e përditshme, brenda një periudhe kohore prej një dite, disa ditësh, disa muajsh</i>	<i>Shembull 1.</i> <i>Prezantimi i situatës:</i> <i>Mësuesi thotë: “Imagjinoni që po tregoni një histori për ditën tuaj që nga zgjimi deri kur shkoni për të fjetur. Çfarë bëni më parë? Çfarë bëni më vonë?”</i>

	Zgjedhja e figurave: Nxënësve u jepen kartolina me figura ose ilustrime të aktiviteteve të zakonshme (mund t'i vizatojnë edhe vetë) dhe detyra e tyre është t'i zgjedhin ato që i përkasin jetës së tyre të përditshme. Renditja praktike: Më pas nxënësi duhet të vendosë figurat sipas radhës kohore: nga mëngjesi deri në mbrëmje. Shënon numrat 1, 2, 3, 4, etj. pranë çdo figure për të treguar rendin. Prezantimi: Secili nxënës prezanton para klasës renditjen e tij: “Unë zgjohem në orën 7. Më pas ha mëngjes, shkoj në shkollë, luaj me shokët, ha darkë dhe fle gjumë.” Reflektimi: Mësuesi i udhëzon nxënësit të reflektojnë nëpërmjet pyetjeve: “Pse duhet t'i rendisim gjërat sipas kohës?”, “Si na ndihmon kjo në jetën e përditshme?”
Shembull 2. Nxënësi grumbullon, zbulon ose klasifikon grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie ose dy cilësive të përbashkëta (ngjyra, forma, trashësia etj.).	Shembull 2 Prezantimi i situatës: Mësuesi i shpjegon nxënësve: “Sot do të bëheni gjuetarë! Duhet të mbledhni sende dhe t'i vendosni në grupe sipas cilësive që kanë të përbashkëta.” Zbulimi i sendeve: Mësuesi vendos shumëllojshmëri sendesh në një tryezë ose në një kënd të klasës. Nxënësit, me radhë ose në grupe, ose në çift zgjedhin disa sende. Klasifikimi: Nxënësit ndajnë sendet në grupe sipas një cilësie të vetme (p.sh. vetëm ngjyra) ose dy cilësive (p.sh. ngjyra dhe forma). Për shembull: Grupi 1 ka zgjedhur sende të kuq dhe rrethorë. Grupi 2 ka zgjedhur sende të kaltër dhe katrorë. Grupi 3 ka zgjedhur sende të kuq dhe topa. Mund të përdoren edhe kuti ose fletë me etiketa për secilin grup. Diskutimi: Mësuesi pyet: “Si i zgjodhët sendet për secilin grup?”; “A mund t'i ndani ndryshe nëse ndryshojmë cilësinë?”; “Cilat cilësi janë më të lehta për t'u dalluar?”

<i>Reflektimi: Në fund, nxënësit mund të klasifikojnë të njëjtat sende, por këtë herë sipas një cilësie tjetër, për të kuptuar që një objekt mund të ketë më shumë se një cilësi që mund të përdoret për klasifikim. Për shembull të gjitha sendet e kuqe.</i>

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e matematikës do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënës, sipas tematikave të lëndës.

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Mësimdhënia e matematikës në arsimin fillor ka për qëllim që nxënësit jo vetëm të mësojnë rregullat, formulat, veprimet, por mbi të gjitha të zhvillojnë mënyrën se si mendojnë, kuptojnë dhe zgjidhin probleme. Matematika nuk është thjesht veprim me numra, por një mjet i rëndësishëm për të kuptuar botën që i rrethon dhe për të ndërtuar aftësi jetësore. *Nxënësit janë të ndryshëm, ndaj mësimdhënia duhet të përshtatet me ritmet, interesat dhe mënyrat e të nxënës të secilit.* Disa nxënës mësojnë më mirë përmes lojës, disa përmes diskutimeve, disa përmes vizualizimeve, ndërsa të tjerë duke përdorur mjete konkrete, teknologji apo punë të pavarur. Për këtë arsye, mësuesit duhet të përdorin një shumëllojshmëri metodash dhe qasjesh për të siguruar që secili nxënës të ketë mundësi të përparojë. Mësimdhënia e matematikës për nxënësit në arsimin fillor përfshin:

- *Të nxënës aktiv:* Nxënësit mësojnë më mirë kur përfshihen në mënyrë aktive përmes lojërave, punimeve me dorë, zgjidhjes së problemeve dhe aktiviteteve praktike. Pjesëmarrja e tyre i ndihmon të ndërtojnë kuptime të qëndrueshme për konceptet matematikore.
- *Të kuptuarit e koncepteve:* Mësimi i matematikës duhet të fokusohet në kuptimin e thellë të koncepteve dhe jo në të mësuarit përmendësh. Konceptet duhet të lidhen me përvoja të jetës reale, si për shembull: matja e gjatësisë së një objekti, llogaritja e shumës së parave, apo planifikimi i një udhëtimi të thjeshtë.
- *Të nxënës e bazuar në problem dhe situatë reale:* Nxënësit përballen me situata që kërkojnë mendim kritik dhe zgjidhje kreative. Shembuj të tillë mund të jenë: “Si mund të ndash një tortë mes 4 shokëve në pjesë të barabarta?” ose “Si mund të gjesh rrugën më të shkurtër për të shkuar në shkollë?”

- *Përdorimi i mjeteve konkrete dhe vizuale:* Për të kuptuar konceptet abstrakte, nxënësit përdorin objekte si karta numrash, forma gjeometrike, figura vizatimore që i ndihmojnë të mendojnë me logjikë dhe të shohin lidhjet mes numrave dhe formave.
- *Mësim i diferencuar dhe i personalizuar:* Çdo nxënës ka nevojë dhe mënyra të ndryshme të të nxënësve. Mësuesi duhet të përdorë metoda të ndryshme, të ofrojë udhëzime dhe mbështetje sipas nevojës, duke respektuar ritmin individual të nxënësit.
- *Integrimi i teknologjisë dhe qasjes STEM:* Përdorimi i softuerëve mësimorë, aplikacioneve dhe lojërave digjitale, eksperimenteve që përmbajnë qasje STEM e bën matematikën më tërheqëse dhe ndihmon nxënësit të vizualizojnë problemet dhe t'i zgjidhin ato në mënyrë interaktive.
- *Të mësuarit bashkëpunues:* Nxënësit mësojnë duke punuar së bashku në grupe të vogla, ku ndajnë ide, diskutojnë dhe zgjidhin probleme si ekip. Kjo nxit komunikimin, mendimin kritik dhe aftësinë për të punuar me të tjerët.
- *Përdorimi i stileve të të nxënësve:* Për të siguruar një mësimdhënie efektive të matematikës në arsimin fillor, është e rëndësishme që mësuesit të njohin dhe të përfshijnë stilet e ndryshme të të nxënësve. Pavarësisht se çdo nxënës mund të ketë një stil dominant të të nxënësve, shumica e nxënësve përdorin një përzierje të stileve të ndryshme. Kjo kërkon që mësuesit të zhvillojnë një metodologji të mësimdhënies që të jetë e ndryshueshme dhe të mundësojë angazhimin e nxënësve në mënyra të ndryshme.
- *Të nxënësve bazuar në projekt dhe lidhja me jetën reale:* Matematika bëhet më kuptimplotë kur nxënësit e shohin si pjesë të jetës së tyre të përditshme, për shembull, llogaritja e kohës, blerja në dyqan, ndarja e ushqimeve, organizimi i një feste apo matja e distancave gjatë një shëtitjeje.
- *Vlerësimi formues:* Mësuesi përdor pyetje, ushtrime të shkurtra, kuize apo vëzhgime gjatë orës, për të kuptuar nivelin e të nxënësve dhe për të ofruar ndihmën e duhur në kohën e duhur, si metodë mësimdhënie dhe jo vetëm si pjesë e vlerësimit të nxënësit.
- *Reflektimi:* Nxënësit inkurajohen të mendojnë për mënyrën se si kanë arritur zgjidhjet, të diskutojnë mbi hapat që kanë ndjekur dhe të eksplorojnë mënyra të reja për të zgjidhur probleme.
- *Zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj matematikës:* Një mjedis mbështetës, i qetë dhe i motivues ndihmon nxënësit të ndihen të sigurt dhe të shijojnë mësimin e matematikës. Kjo rrit besimin e tyre në vetvete dhe dëshirën për të mësuar më shumë.

- *Të nxënit socioemocional:* Në lëndën e matematikës, krahas zhvillimit të aftësive logjike dhe numerike, është shumë e rëndësishme që nxënësit të zhvillojnë edhe aftësi socioemocionale, aftësi që nxisin vetëbesimin, që lidhen me vetëdijen, kontrollin e emocioneve, bashkëpunimin dhe respektin për të tjerët, aftësi që forcojnë vetëvlerësimin dhe vetëkontrollin.

6.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e matematikës

Një nga mënyrat më efektive për të ndërtuar kuptimin matematikor është përfshirja e situatave praktike dhe atyre nga jeta reale në orën e mësimit. Kur nxënësit zgjidhin probleme që lidhen me situata konkrete kontekstuale si: matja e distancës nga shtëpia në shkollë, krahasimi i çmimeve në dyqan, ose ndarja e ëmbëlsirave mes shokëve, ata kuptojnë se matematika nuk është vetëm një lëndë shkollore, por një pjesë e jetës së tyre të përditshme.

Situatat e të nxënit ndihmojnë nxënësit:

- të kuptojnë vlerën praktike të matematikës;
- të zhvillojnë mendimin logjik, krijues dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve;
- të bëhen më të pavarur dhe të sigurt në përdorimin e matematikës jashtë mjedisit të klasës.

Në këtë mënyrë, mësimdhënia e matematikës nuk kufizohet vetëm brenda mureve të klasës, por shtrihet në çdo aspekt të jetës së nxënësit, duke ndihmuar në ndërtimin e kompetencave të nevojshme për të ardhmen.


6.2 Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e matematikës

Projektet kurrikulare përbëjnë një pjesë të rëndësishme të procesit mësimor në matematikë, pasi u japin mundësi nxënësve të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në mënyrë funksionale dhe kreative. Përmes projekteve kurrikulare, nxënësit përballen me situata që kërkojnë zbatimin e koncepteve matematikore në kontekste të jetës reale, duke nxitur kështu mendimin kritik, punën në grup, zgjidhjen e problemeve dhe komunikimin e ideve.

Projektet mund të lidhen me fusha të ndryshme të jetës, si: matjet dhe përlogaritjet për ndërtimin e një modeli, zbatimi i statistikave për analizimin e të dhënave reale, planifikimi i buxheteve për një ngjarje shkollore, ose projektimi i objekteve gjeometrike në hapësirë. Këto detyra jo vetëm që fuqizojnë të kuptuarit e koncepteve, por gjithashtu i ndihmojnë nxënësit të shohin vlerën praktike të matematikës në jetën e përditshme.

Mësuesi ka rolin udhëheqës në këtë proces, duke udhëzuar nxënësit në çdo hap: që nga formulimi i pyetjeve, planifikimi i punës, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, interpretimi i rezultateve dhe prezantimi i gjetjeve. Projektet krijojnë gjithashtu një hapësirë për integrimin ndërdisiplinor, duke bashkuar matematikën me lëndë të tjera si shkenca, teknologjia, gjeografia apo ekonomia. Në diagramin 3, jepet një shembull i një situate të nxëni nga jeta reale, që mund të përdoret si ide edhe për projektin kurrikular.

Diagrama 3. Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit



6.3 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e matematikës

Në orën e matematikës të gjithë nxënësit duhet të ndihen të përfshirë dhe të vlerësuar. Disa nxënës kanë nevojë për ndihmë më të veçantë, sepse mund të mësojnë me ritëm më të ngadaltë ose kanë mënyra të ndryshme të të kuptuarit. Mësuesi ka një rol të rëndësishëm që t'i ndihmojë këta nxënës duke:

- përdorur ushtrime të thjeshta dhe të përshtatura për nivelin e tyre;
- përdorur mjete konkrete (lodra, figura, karta) dhe skema për të lehtësuar kuptimin e numrave dhe veprimeve;
- organizuar punë në grupe të vogla ose në çifte, ku nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin;
- dhënë udhëzime të qarta dhe pyetje që i ndihmojnë të mendojnë hap pas hapi;
- përdorur kompjuterë, tableta ose mjete vizuale që e bëjnë mësimin më të lehtë dhe më argëtues.

6.4 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e matematikës

Nxënësit që tregojnë interes të veçantë dhe aftësi më të mira në matematikë apo STEM kanë nevojë për më shumë sfida që t'i ndihmojnë të mendojnë në thellësi të koncepteve si dhe të zbatojnë njohuritë në situata të reja dhe krijuese. Mësuesi mund t'i motivojë dhe inkurajojë këta nxënës duke:

- dhënë detyra më sfiduese që kërkojnë disa mënyra zgjidhjeje;
- i ftuar që të formulojnë vetë probleme matematikore dhe të kërkojnë zgjidhje kreative;
- organizuar diskutime e debate për të sqaruar dhe mbrojtur mendimet e tyre;
- i përfshirë në lojëra matematike ose aktivitete me pyetje interesante që stimulojnë logjikën;
- inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në konkurse, olimpiada ose sfida jashtë klase për të ushtruar aftësitë.

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e matematikës do të paraqiten në mënyrë të detajuar veprimtaritë praktike për zbatimin e metodave të mësidhënies.

VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në mësimin e matematikës, vlerësimi i nxënësve në arsimin fillor, është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor dhe ndihmon mësuesit të kuptojnë sa mirë i përvetësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Në lëndën e matematikës qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një përshkrimi ose note, por:

- t'i japë nxënësit mundësi të kuptojë progresin e vet dhe të mësojë nga gabimet duke reflektuar;
- të ndihmojë mësuesin të shohë sa mirë janë kuptuar konceptet dhe si po zbatohen;
- të drejtojë mësuesin në përmirësimin e metodës së mësimdhënies.

7.1 Llojet e vlerësimit në lëndën e matematikës

Vlerësimi diagnostikues (vlerësimi si proces të nxëni)

Ky lloj vlerësimi bëhet në fillim të vitit shkollor ose të një teme të re. Mësuesi zbulon njohuritë që nxënësi ka dhe identifikon çfarë ka nevojë të përsëritet ose të mësohet më mirë.

Ky vlerësim mund të realizohet:

- ✓ me pyetje të thjeshta
- ✓ me ushtrime të shkurtra
- ✓ me kuice të shkurtra
- ✓ me lojëra ose biseda, etj.

Vlerësimi formues (vlerësimi i vazhduar, vlerësimi për të nxënë)

Ky vlerësim bëhet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, për të parë si po ecin nxënësit. Ai ndihmon nxënësit dhe mësuesin të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur dhe çfarë duhet përmirësuar.

Teknika të vlerësimit formues janë:

- ✓ vlerësimi i punës në grupe
- ✓ vëzhgimi i pjesëmarrjes gjatë mësimit
- ✓ detyrat e përditshme dhe projektet e vogla
- ✓ vlerësimi i diskutimeve
- ✓ vlerësimi i përgjigjeve
- ✓ vetëvlerësimi dhe vlerësimi i shokut, etj.

Vlerësimi përmbledhës (vlerësimi periodik, vlerësimi i të nxënës)

Ky vlerësim bëhet pas një periudhe mësimore, ose pas një kapitulli dhe mat atë që nxënësi ka arritur të mësojë. Mund të realizohet me teste. Kjo zakonisht shoqërohet me përshkrimin e vlerësimit ose me notë dhe ndihmon mësuesin, nxënësin dhe prindërit të kuptojnë progresin dhe arritjet.

7.2 Parime të rëndësishme të vlerësimit në arsimin fillor (matematikë)

- Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit të mësojnë më mirë, të kuptojnë gabimet dhe të reflektojnë mbi to.
- Detyrat dhe pyetjet e vlerësimit duhet të matin njohuritë dhe aftësitë që kërkojnë kompetencat matematikore.
- Vlerësimi duhet të jetë i qartë, i drejtë dhe i përshtatshëm për të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre.
- Vlerësimi duhet të inkurajojë nxënësit të besojnë në vetvete dhe të kuptojnë që gabimi është pjesë e të nxënës.
- Mësuesi përdorë shumë forma vlerësimi, si: përgjigje me gojë, ushtrime, punë me materiale konkrete, projekte, vizatime, punë në grup, detyra shtëpie etj.

Ky proces ndihmon që vlerësimi të bëhet një mjet i dobishëm dhe i kuptueshëm për të gjithë, jo vetëm një "kontroll" për nota, por një mënyrë për të ndihmuar nxënësit të rriten dhe të përmirësohen çdo ditë në mësimin e matematikës.

7.3 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënës (RN)

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënës.

Tabela 6. Shembuj për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve

Shembull 1. Rezultati i të nxënit (RN): Nxënësi rendit ngjarje të jetës së përditshme brenda një periudhe (një dite, disa ditë, disa muaj).				
Niveli i arritjes: Shkëlqyeshëm	Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi rendit me saktësi dhe qartësi ngjarje që lidhen me jetën e përditshme, duke i vendosur ato në rend kronologjik brenda një periudhe kohore të caktuar (një ditë, disa ditë, disa muaj) duke përdorur shprehje kohore të përshtatshme (si "në mëngjes", "pasdite", "muajin e kaluar", etj.) dhe jep arsye të renditjes së ngjarjeve.	Nxënësi rendit saktë dhe me qartësi ngjarjet, duke respektuar radhën kronologjike të ditës, javës apo muajve dhe arrin t'i shpjegojë me fjalët e veta duke i lidhur ato me situata reale.	Nxënësi rendit ngjarjet kryesisht saktë sipas kohës dhe i përshkruan me pak ndihmë ose udhëzim nga mësuesi.	Nxënësi rendit disa ngjarje në mënyrë të pjesshme, me gabime ose pa respektuar plotësisht rendin kronologjik dhe ka nevojë për ndihmë për shpjegimin e tyre.	Nxënësi nuk arrin të rendisë saktë ngjarjet ose i ngatërron ato pavarësisht ndihmës së dhënë, nuk kupton qartë lidhjen kohore të tyre.
Shembull 2. Rezultati i të nxënit: Nxënësi grumbullon, zbulon ose klasifikon grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie ose dy cilësive të përbashkëta (ngjyra, forma, trashësia etj.).				
Niveli i arritjes: Shkëlqyeshëm	Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi grumbullon dhe klasifikon me saktësi sende apo	Nxënësi grumbullon dhe klasifikon saktë sendet/figurat	Nxënësi klasifikon kryesisht saktë	Nxënësi arrin të klasifikojë pjesërisht ose	Nxënësi e ka të vështirë të grumbullojë apo klasifikojë

figura sipas një ose dy cilësive të përbashkëta. Tregon kuptim të qartë të kriterëve të përzgjedhura dhe shpjegon me qartësi mënyrën e klasifikimit. Shfaq vëzhgim të mprehtë dhe mendim logjik.	në bazë të një apo dy cilësive pa ndihmë dhe shpjegon qartë kriteret që ka përdorur.	sendet/figurat sipas cilësive të dhëna me pak ndihmë nga mësuesi dhe arrin të japë një shpjegim të thjeshtë.	me gabime sendet/figurat dhe ka nevojë për ndihmë për të kuptuar kriteret e klasifikimit.	sendet/figurat sipas cilësive të caktuara, edhe pas udhëzimeve nga mësuesi.
--	--	--	---	---

Në udhëzuesit kurrikularë të lëndës së matematikës do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënës, sipas tematikave të lëndës.

VIII. BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Gjatë orëve të matematikës, mësuesi duhet të përdor mjete të ndryshme që ndihmojnë nxënësit të mësojnë më lehtë dhe më me kuptim. Nxënësit kanë mundësinë që të prekin, të shikojnë, të dëgjojnë dhe të përdorin materiale konkrete, të cilat i ndihmojnë të kuptojnë më mirë konceptet matematikore.

Mësuesi përdor mjete të ndryshme vizuale si:

- figura, tabela, bosht numrash, harta konceptesh,
- objekte reale për matje dhe numërim,
- mjete teknologjike (si projektorë, kompjuterë, tabletë, lojëra digjitale dhe platforma mësimore online).

Po ashtu, mësuesi shpjegon me fjalë të qarta dhe të thjeshta, duke përdorur fjalë të shkurtra dhe fjalor të kuptueshëm për moshën e nxënësve. Ai/ajo zgjedh shembuj dhe ushtrime të përshtatura sipas nevojave të secilit nxënës, duke dhënë ndihmë shtesë aty ku është e nevojshme.

Përveç tekstit shkollor, mësuesi përdor fletore pune, materiale ndihmëse, ushtrime shtesë dhe platforma digjitale, që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të zbatojnë më mirë matematikën. Nxënësit inkurajohen të shprehin njohuritë e tyre jo vetëm me gojë apo me shkrim, por edhe përmes projekteve, vizatimeve dhe prezantimeve të vogla.

Në lëndën e matematikës mësuesi duhet të përdorë librin origjinal të mësuesit me tekstin e nxënësit, i cili përmban veprimtaritë mësimore për secilën temë mësimore.

8.2 Përdorimi i teknologjisë si mjet dhe teknikë mësimore për zbatimin e qasjes STEM

Për t'i dhënë matematikës vendin që i takon në zhvillimin e mendimit logjik dhe zgjidhjen e problemeve, sugjerohet që mësimi të zhvillohet edhe në klasa të pajisura me mjetet si: tabela interaktive, laboratorë “smart” dhe programe digjitale. Në ditët e sotme, teknologjia është bërë një mjet ndihmës shumë i rëndësishëm për mësimin e matematikës. Matematika lidhet ngushtë me qasjen STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë).

Kjo qasje ndihmon nxënësit të mendojnë si shkencëtarë të vegjël, të zgjidhin probleme si inxhinierë, të përdorin teknologjinë si ndihmës dhe të përdorin matematikën për të kuptuar botën që i rrethon. Disa mënyra si TIK dhe qasja STEM ndihmojnë në mësimin e matematikës:

- *Përdorimi i programeve mësimore dhe lojërave digjitale.* Nxënësit përdorin aplikacione, softuer edukativ për të ndërtuar figura, tabela, grafikë dhe për të zgjidhur ushtrime të ndryshme në mënyrë argëtuese dhe të kuptueshme.
- *Mbledhja, organizimi dhe analizimi i të dhënave.* Nxënësit mësojnë si të mbledhin të dhëna, t'i organizojnë në tabela ose grafikë dhe t'i analizojnë, duke kuptuar më mirë botën përreth, një aftësi shumë e rëndësishme në shkencë dhe matematikë.
- *Ndërtimi i figurave gjeometrike dhe eksperimentimi vizual.* Duke përdorur mjete digjitale, nxënësit mund të krijojnë forma gjeometrike, t'i ndryshojnë ato dhe të kuptojnë lidhjet mes formave, madhësive dhe këndeve, ashtu si bëjnë inxhinierët dhe arkitektët.
- *Hapat e parë në programim dhe kodim.* Me ndihmën e aplikacioneve të thjeshta si Scratch, nxënësit mund të mësojnë të programojnë lojëra ose lëvizje të thjeshta, duke forcuar aftësitë për të menduar në mënyrë logjike dhe për të zgjidhur probleme.
- *Përdorimi i burimeve online dhe platformave interaktive.* Nxënësit mësojnë duke përdorur platforma edukative që ofrojnë mësimë interaktive, sfida matematikore dhe ushtrime të përshtatura për nivelin e tyre.
- *Bashkëpunimi për projekte STEM.* Nxënësit mund të punojnë së bashku përmes internetit, për të zgjidhur probleme ose për të ndërtuar projekte të vogla STEM.

- *Përdorimi etik dhe i sigurt i teknologjisë.* Nxënësit mësojnë të jenë të sjellshëm dhe të kujdesshëm kur përdorin internetin, të respektojnë autorët e materialeve dhe të mbrojnë privatësinë e tyre.

Qasja STEM i ndihmon nxënësit jo vetëm të mësojnë matematikë, por edhe të mendojnë si hulumtues, shpikës dhe zgjidhës problemesh, duke lidhur matematikën me jetën reale, shkencën, teknologjinë dhe inxhinierinë. Në këtë mënyrë, mësimi i matematikës bëhet një aventurë e dobishme për të ardhmen!

Në udhëzuesit kurrikularë të matematikës do të jepen shembuj konkretë për përdorimin e këtyre burimeve e materialeve, si edhe udhëzime të detajuara për integrimin e teknologjisë në mësimdhënie.

IX. ANALIZA SASIORE E PROGRAMIT TË MATEMATIKËS NË KLASË TË 1-RË

ANALIZA SASIORE E PROGRAMEVE LËNDORE	Klasa 1
PËRMBAJTJA E MATEMATIKËS SIPAS TEMATIKAVE	100%
Numri	69%
Matjet	13%
Gjeometria	10%
Algjebra dhe funksioni	4%
Statistika dhe probabiliteti	4%
Provimet kombëtare	0%
LLOJI I KONCEPTEVE	100%
Koncepte bazë	75%
Zgjerim të koncepteve	20%
Koncepte të thelluara	5%
ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE MATEMATIKORE	100%
Lidhja konceptuale	15%

Zgjidhja problemore	45%
Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	15%
Të menduarit matematik	10%
Modelimi matematik	10%
Të menduarit kompjuterik / teknologjia	5%
METODOLOGJIA E ZBATIMIT Të PROGRAMEVE MATEMATIKORE	100%
Konceptet e reja matematikore	45%
Ushtrime dhe përpunim i njohurive (zbatim praktik)	35%
Mendimi kritik dhe situata nga jeta reale	10%
Projekte kurrikulare dhe veprimtari ndërkurrikulare	5%
Vlerësimi i nxënësit	5%
INTEGRIMI NDËRLËNDOR	100%
Gjuhë / komunikim	35%
Shkenca natyrore	25%
Shkencat shoqërore	15%
TIK / teknologji	10%
Art /paraqitje vizuale/dizajn	5%
Përmbajtje vetëm matematikore	10%

X. REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit të lëndës së matematikës mbështetet në Kornizën Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë, Planin Mësimor të Arsimit Bazë dhe në rekomandimet më të fundit të Bashkimit Evropian për arsimin. Si i tillë, ky dokument i shërben nxënësve, mësuesve, autorëve të teksteve shkollore, hartuesve të testeve kombëtare, vlerësuesve të jashtëm të cilësisë dhe prindërve. Më poshtë paraqiten rekomandime për zbatuesit e programit, me synimin të maksimizohet efektiviteti i tij.

a) Rekomandime për mësuesit

- ✓ Të lidhin përmbajtjen e matematikës me fusha të tjera (shkencë, teknologji, inxhinieri, art, gjuhë, edukatë qytetare, etj.) për të ndihmuar kuptimin e thelluar dhe zbatimin praktik të njohurive.
- ✓ Të përdorin qasjen STEM përmes projekteve, eksperimenteve dhe zgjidhjes së problemeve reale.
- ✓ Të krijojnë aktivitete praktike që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e matematikës në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me profesione të ndryshme.
- ✓ Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe për fëmijët me aftësi me talente.
- ✓ Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socioemocional.
- ✓ Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet e marginalizuara.
- ✓ *Të sigurojnë balancën mes teorisë dhe praktikës (p.sh. sugjerohet 50% teori — 50% praktikë). Përdorimi praktik i matematikës do të realizohet jo vetëm në orët e veçanta si: ushtrime, përsëritje, projekte, konkurse etj., po përgjatë çdo ore mësimore. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.*
- ✓ Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e matematikës.

- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së teksteve shkollore.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së matematikës.
- ✓ Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

b) Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- ✓ Të përshtatin në mënyrë cilësore tekstet shkollore duke reflektuar të gjitha përditësimet më të fundit.
- ✓ Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e matematikës, në tekstet shkollore.
- ✓ Të sigurojnë librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së tekstit shkollor.
- ✓ Të sigurojnë materialet burimore edhe digjitale për zbatimin e tekstit shkollor.
- ✓ Të lidhin konceptet matematikore me fusha të tjera dhe me situata të jetës reale, në tekstet shkollore.
- ✓ Të përfshijnë në tekstet shkollore ushtrime që promovojnë mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe krijimtarinë në kuadër të qasjes STEM.
- ✓ Të krijojnë hapësira në tekstet shkollore për shembuj dhe ushtrime që nxisin orientimin për karrierë, përmes profesioneve ku matematika luan rol.
- ✓ Të sigurojnë që tekstet të kenë qasje gjithëpërfshirëse, të përshtatshme për moshën, diversitetin kulturor dhe aftësitë e ndryshme të nxënësve.

c) Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare

- ✓ Të sigurojnë që testet të përmbajnë jo vetëm ushtrime teorike, por edhe ushtrime me zbatime praktike në jetën reale.
- ✓ Të integrojnë qasje ndërdisiplinore që nxisin logjikën, mendimin kritik dhe krijues.
- ✓ Të përfshijnë pyetje që lidhin konceptet matematikore me koncepte të lëndëve apo fushave të tjera.
- ✓ Të kenë parasysh nivelin e diversitetit të nxënësve, duke përfshirë ushtrime që janë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë, pavarësisht sfondit kulturor ose gjuhësor.
- ✓ Të ruajnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të matematikës në testet kombëtare.

- ✓ Të hartojnë modele të testeve kombëtare në mënyrë që të punohen nga nxënësit gjatë viteve të shkollimit.

d) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve matematikore.
- ✓ Të vlerësojnë përfshirjen e qasjes STEM në planifikimin dhe zbatimin e mësimin të matematikës dhe të projekteve kurrikulare.
- ✓ Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënës.
- ✓ Të vlerësojnë që mësuesit organizojnë punën në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- ✓ Të vlerësojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të matematikës gjatë zhvillimit të orëve mësimore.
- ✓ Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënës dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- ✓ Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socioemocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e matematikës.
- ✓ Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

e) Rekomandime për prindërit

- Të inkurajojnë fëmijët që të kuptojnë rëndësinë e matematikës jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- Të bashkëpunojnë me shkollën për të ndihmuar fëmijët në pjesëmarrjen në projekte të lidhura me matematikën dhe qasjen STEM.
- Të promovojnë një qëndrim pozitiv ndaj mësimin të matematikës, duke theksuar vlerën e përpjekjes e të mësimin nga gabimet.
- Të sigurojnë që mësimi i matematikës zhvillohet në një atmosferë të qetë dhe motivuese për fëmijët e tyre.

f) Rekomandime për nxënësit

- ✓ Të marrin pjesë aktive në orët e matematikës, duke kërkuar të kuptojnë përdorimin praktik të njohurive.
- ✓ Të angazhohen në projekte kurrikulare që lidhin matematikën me fusha të tjera përmes qasjes STEM.

- ✓ Të bashkëpunojnë me shokët për zgjidhjen e problemeve brenda dhe jashtë klase.
- ✓ Të jenë kureshtarë dhe të kërkojnë ndihmë kur hasin vështirësi, duke shfrytëzuar përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimeve online.
- ✓ Të kuptojnë rëndësinë e matematikës si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

XI. NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE

Në lëndën e matematikës së klasës së parë ka këto ndryshime përmbajtësore:

- 1) Vendosja e fokusit më të qartë në situatat praktike të të nxënit duke sugjeruar një raport 50% pjesa teorike dhe 50% pjesa praktike. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- 2) Ka shtim rezultatesh të të nxënit sipas tematikave përkatëse si më poshtë:

a) Numri

- Përshkruan renditjen e objekteve me një gjuhë të thjeshtë matematikore.
- Kupton se zero tregon mungesën e plotë të një sasie apo objekti.
- Paraqet një numër dyshifror deri në 20, në trajtë të zbërthyer.
- Rendit disa numra njëshifrorë dhe dyshifrorë në rendin rritës ose zbritës nga 0 -20.
- Dallon se një objekt apo formë mund të ndahet si në pjesë të barabarta, ashtu edhe në pjesë të pabarabarta.
- Njeh gjysmën si një nga dy pjesët e barabarta të një sasie ose grupi objektesh.
- Kupton se gjysma përdoret për të ndarë një numër në dy pjesë të barabarta dhe se rezultati është një numër i plotë.
- Kupton dhe dallon se dy gjysma mund të bashkohen për të formuar një të tërë.
- Mbledh tre numra njëshifrorë duke zbatuar vetinë e ndërrimit të mbledhjes nga 0-20.

b) Matja

- Krahason drejtpërdrejt gjatësitë e sendeve duke përdorur shprehjet: “më i gjatë”, “po aq i gjatë”, “më i shkurtër”, “më i gjati”, “më i

shkurtri” “i hollë”, “më i hollë”, “i lartë”, “më i lartë”.

- Kërkon dhe zgjedh mjetin e shkallëzuar të përshtatshëm për të matur gjatësinë, masën, kapacitetin dhe temperaturën.
- Njeh kohën në orë dhe gjysmë.

c) Gjeometria

- Përshkruan format 2D duke treguar veçoritë e tyre, si numri i brinjëve dhe nëse ato janë të drejta apo të lakuara.
- Përshkruan objekte me forma 3D bazuar në veçoritë e tyre, si numri i faqeve, i kulmeve dhe nëse faqet janë të sheshta apo të lakuara.
- Bën dallimin mes formave 2D dhe 3D duke përdorur si shembuj objekte praktike.
- Zbulon kur një objekt apo person duket njësoj edhe pasi është rrotulluar.

d) Statistika dhe probabiliteti

- Përdor piktogramet, diagramin e Venit dhe diagramin e Carrolit.
- Përshkruan të dhëna duke përdorur gjuhë të kuptueshme si “më shumë”, “më pak”, “më së shumti” ose “më së paku”, për t’iu përgjigjur pyetjeve jo statistikore dhe për të diskutuar përfundimet.

3) Përditësimi i kompetencave kyçe dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e parë.

4) Përditësimi i kompetencave matematikore dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e parë.

5) Rishikim i temave ndërkurrikulare në përputhje me programin e ri.

6) Përditësimi i metodologjisë me fokus zhvillimi i mendimit kritik e krijues, zgjidhja problemore, qasja STEM, të nxënit e personalizuar, aspekti socioemocional dhe përdorimi i teknologjisë.

7) Përditësimi i vlerësimit të nxënit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënit.